



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ENERGISË DHE MINIERAVE
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING

DATË/A:	PRISHTINË, 13 MARS 2009
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z. Ali Hamiti, Kryesues i Bordit të ZRrE
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Znj. Justina Shiroka-Pula
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i tretë tarifor i energjisë elektrike 2009 – Raporti Konsultativ.

I nderuar z. Hamiti,

Në vazhdim keni disa mendime dhe propozime të bëra nga stafi i MEM-it lidhur me shqyrtimin e tretë tarifor 2009.

Me respekt,

Justina Shiroka-Pula



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ENERGISË DHE MINIERAVE
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING

Shqyrtimi i tretë tarifor i Energjisë elektrike 2009 – Raporti konsultativ

Pika 3. Rregullimi për ndryshimin në mes të shpenzimeve të realizuara dhe atyre të lejuara

Propozimi i ZRrE përkrahet në tërësi.

Pika 4.1 Kostot e propozuara të importit dhe të eksportit

Nuk duket e përshtatshme krahasimi i çmimit të energjisë elektrike në një treg kaotik dhe spekulativ me tregun e konsoliduar të cilin e pasqyron bursa e energjisë EEX. Propozojmë të merren për bazë çmimet e energjisë elektrike në rajon që ofrohen në 3 muajt e parë të këtij viti dhe të prognozohen çmimet për pjesën tjetër të vitit kur pritet të ketë import. Me zhvillimin e rrjetës së bartjes në rajon (interkonekcionet e reja) pritet që të ulët çmimi i alokimit të kapaciteteve dhe me këtë edhe ulja e çmimit të energjisë, krahasuar me vitin e kaluar.

Bazuar në sa më sipër, çmimi i propozuar i importit nga ZRrE duket i lartë dhe propozohet të ulët.

Pika 4.2 Jetëgjatësia e supozuar e aseteve

Jetëgjatësia e supozuar e gjenerimit nuk është e njëjtë për TC Kosova A dhe për Kosova B. Kosova A pritet të dalë nga funksioni në vitin 2017, ndërsa Kosova B së paku 10 vite më vonë!

Kjo duhet të merret në konsiderim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ENERGISË DHE MINIERAVE
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING

Pika 4.3 Humbjet e lejuara

Humbjet e lejuara në nivelin e lartësisë së realizuar gjatë vitit 2008 (për KEK 37.1% e jo 37.4% që duket të jetë gabim shtypi!) nuk stimulojnë përpjekjet e KEK sh.a. për zvogëlimin e tyre.

Propozojmë të bëhen rregullime adekuate.

Pika 4.4 Shpenzimet e lejuara të mirëmbajtjes për KOSST

Shuma e lejuar për KOSST duket e lartë, sidomos kur merren parasysh vlerat e realizuara në vitin 2008 dhe vëllimi i punëve që tashmë është kryer gjatë atij viti.

VËREJTJE

Shpenzimet e lejuara të mirëmbajtjes së gjenerimit duhet të trajtohen veçmas. Roli dhe rëndësia që kanë TC Kosova A dhe B tani dhe në vitet që vijnë kërkojnë trajtim të posaçëm dhe fonde të sigurta për mirëmbajtje cilësore dhe për remonte periodike sipas normave teknike për objekte të tilla dhe vjetërsisë që ato kanë. Për këto qëllime zvogëlimet që mund të dalin nga pikat e ndryshme duhet të shtohen në pozicionin e mirëmbajtjes së Divizionit të gjenerimit.

Pika 4.5 Propozimi i ZRrE përkrahet në tërësi.

Pika 4.6 Propozimi i ZRrE përkrahet në tërësi.

Pika 4.7 Propozimi i ZRrE përkrahet në tërësi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ENERGISË DHE MINIERAVE
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING

Pika 5 Përmbledhje e të ardhurave të lejuara

Bazuar në ato që u propozua më lartë presim që ZRrE, duke zbatuar mandatin ligjor që ka, të vlerësojë Propozimin e MEM dhe të bëjë rregullimet adekuate.

Pika 6. Rregullimet e Propozuara Tarifore

MEM beson se rregullimet e reja tarifore do të marrin në konsiderim konsumatorët në nevojë dhe tarifën për bllokun deri në 200 kWh nuk do ta rrisin.